



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2 dhe nenit 25, paragrafët 1, 2 dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me 02.05.2019, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ilir (Ajet) Sogojeva, Sabri (Ajet) Sogojeva, Ajet (Sami) Sogojeva, Albulena (Sami) Sogojeva dhe Agron (Sami) Sogojeva.
- II. Prona e paluajtshme e Komunës që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 02674-1, e evidentuar në certifikatën e pronësisë nr. P-71914059-02674-1, e destinuar për ndërtim, Zona kadastrale (ZK) Prishtinë, Kuvendi Komunal Prishtinë, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesa e parcelës kadastrale 02759-2, ZK Prishtinë, e evidentuar në certifikatën e pronësisë nr. P-71914059-02759-2, Zona kadastrale (ZK) Prishtinë, në emër të pronarëve Ilir (Ajet) Sogojeva, Sabri (Ajet) Sogojeva, Ajet (Sami) Sogojeva, Albulena (Sami) Sogojeva dhe Agron (Sami) Sogojeva, e destinuar për infrastrukturë rrugore sipas Planit rregullues "Muhaxhirët".
- III. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë, pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Muhaxhirët".
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelave kadastrale që do të këmben.

- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:
- skica gjeodezike,
 - kopja e planit dhe
 - certifikatat e pronësisë.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-0101088/19, më 03.05.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

